

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS, KAPSHTICË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën e Doganës, Kapshticë, me objekt “Mbi zbatimin e legjislacionit doganor” për periudhën viti 2012-2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 82, datë 30.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 322/7, datë 30.06.2014 dhe nr. 322/8, datë 30.06.2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar znj. Elisa Spiropali, Drejtor i Përgjithshëm i Doganave, Tiranë dhe z. Ilir Cenolli, Kryetar i Degës Doganës, Kapshticë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Dega e Doganës Kapshticë, autoriteti doganor kompetent, duke përdorur të gjitha rrugët dhe mjetet ligjore në dispozicion të marrë masa që të mos ndërpriten ritmet e rikuperimit të borxhit doganor, mbetur pa u arkëtuar në vlerë 30,356 mijë lekë, lënë detyrë në auditimin e mëparshëm si dhe për rikuperimin e borxhit doganor rezultuar gjendje më datë 31.12.2013, për 191 raste, 97 subjekte në vlerë 67,757 mijë lekë.

2. Dega e Doganës Kapshticë, autoriteti doganor kompetent, të dërgojë për investigim në Departamentin Operativ-Hetimor (Drejtoria e Hetimit), pranë DPD praktikant doganor Imp. 4, R-14540, datë 04.12.2013, R-14959, datë 13.12.2013, R-15137, datë 17.12.2013, R-15298, datë 20.12.2013, R-15450, datë 23.12.2013 dhe R-15761, datë 30.12.2013 të subjektit [REDAKTUAR], me të gjithë dokumentacionin tregëtar që gjendet bashkëlidhur praktikës.

3. Dega e Doganës Kapshticë, të nxjerrë urdhër të brendshëm në mënyrë që doganierët e klasifikim-vlerësimit doganor, të lënë gjurmë mbi mënyrat e vlerësimit të mallrave, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 19, ku thuhet: *“Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve”*, si dhe të udhëzimit nr. 25 datë 30.11.2007, pika 6.

4. Dega e Doganës Kapshticë, të marrë masa që të gjitha kontratat që lidhin operatorët ekonomikë vendas me eksportuesit e mallrave, të përmbushin të gjitha elementët ligjorë, për t’u pranuar si të tilla, mbasi është vepruar në kundërshtim me VKM nr.134 datë 07.03.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit”.

5. Dega e Doganës Kapshticë, autoriteti doganor kompetent, të marrë masa:

-Për të ndaluar pranimin e dokumenteve fotokopjo, të cilat shoqërojnë deklaratat doganore në procesin e zhdoganimit të mallrave dhe pranohen nga administrata doganore për vlerësimin e indikatorëve si ; kontrata, fatura e shitjes, CMR-ja, delarata e eksportit, certifikata e origjinës, lista e parkingut, librezja e mjetit, në raste të veçanta edhe EUR. 1, veprime këto që bien në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 205, datë 13.05.1999 “Dispozitat Zbatuese” dhe të udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007, të Ministrisë së Financave.

- Në asnjë rast të mos mungojë bashkëlidhur praktikave doganore prokura e përgjithshme, akti i përfaqësimit të drejtepërdrejtë, apo të tërthortë të subjektit nga agjencia doganore e cila duhet të jetë e regjistruar dhe e shoqëruar me kartën e identitetit të agjentit doganor, të gjitha këto në zbatim të kërkesave të neneve 17, 26 të Kodit Doganor, VKM nr. 205, datë 13.03.1999 “Për dispozitat

zbatuese të KD” të ndryshuar, si dhe pikat 35, 36, 37/2, të udhëzimit nr. 9, datë 19.12.21999 dhe neneve 70,76 të Kodit Civil.

6. Dega e Doganës Kapshticë, të nxjerrë urdhër të brendshëm për të vënë në funksionim Komisionin e Vlerësimit Doganor, për të vlerësuar ato mallra për të cilat përgjegjësi i turnit dhe doganieri i vlerësimit shfaqin rezerva, për rastet kur mungojnë të dhënat e disponueshme të publikuara nga DPD, si dhe për mallrat e përdorur.

7. Dega e Doganës Kapshticë, të marrë masa të plota për inventarizimin, protokollimin dhe arkivimin me procesverbal në arkivin e doganës të dosjeve të subjekteve që kanë përfituar nga skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së, si dhe të instalojë një bashkëpunim të plotë të autoritetit doganor kompetent me subjektet përfituese, në drejtim të zbatimit të afateve ligjore të likuidimit dhe të llogaritjes së interesit për detyrimin e TVSH-së së pa paguar në afat.

8. Dega e Doganës Kapshticë, të marrë masa që Kontrolli A/posteriori dhe doganierët e Zyrës Mbikëqyrëse të Regjimeve, të auditojnë dhe të analizojnë diferencat e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të rezultuara nga auditimi i KLSH-së, bazuar vetëm në krahasimin e deklarimeve të subjektit me dokumentet e mbylljes së regjimit, të saktësohen këto diferenca në ambientet e subjektit, nëpërmjet ballafaqimit me dokumentet kontabël të subjektit, të analizohen faktet, të nxirren përgjegjësitë dhe të llogariten detyrimet me destinacion të ri doganor, për të gjitha diferencat e rezultuara rast pas rasti.

9. Dega e Doganës Kapshticë të marrë masa:

-Për ndërprerjen në mënyrë të menjëhershme të pranimit të dokumentimit të origjinës preferenciale, të të gjitha rasteve që vijnë në kundërshtim me Rregulloren nr.1 datë 14.07.2009 “Mbi statusin e eksportuesit të miratuar” ku thuhet: *“Eksportuesi i miratuar pajiset me nje numur identifikues, i cili paraqitet në shënimin e specifikuar ne faturë”*, si dhe me Udhëzimin e DPD-së shkresa nr. 5883, datë 16.05.2006 “Dokumentacioni i detyrueshëm për vërtetimin e origjinës preferenciale” pika 2, ku thuhet: *“Deklaratë faturë” e cila mund të paraqitet nga eksportuesi i aprovuar, kur produktet janë origjinuese. Çdo eksportues i aprovuar ka një numër autorizimi doganor dhe që shfaqet në deklartën faturë, nga një eksportues i një dërgese të përbërë nga një ose më shumë produkte origjinuese vlere e të cilave nuk kalon 6000 euro*. Mungesa e dokumentacionit të mësipërm ndalon kategorikisht trajtimin tarifor preferencial”, kur nuk plotësohen kërkesat e mësipërme.

-Në zbatim të Kodit Doganor neni 32, pika 3 “Origjina preferenciale e mallrave” ku thuhet: *“Rregullat mbi origjinën preferenciale, si dhe formalitetet për lëshimin e certifikatave të origjinës preferenciale përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi”*, me nenin 47-52, të VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë” me ndryshime, me Udhërrëfyesin “Mbi rregullat e origjinës preferenciale”, si dhe “Dokumentet që vërtetojnë origjinën e mallit”, të ndërpritet pranimi i certifikatave EUR.1 si dokument që vërteton origjinën në të gjitha rastet kur ato nuk janë të plotësuara sipas kërkesave të formularit EUR.1 si dhe nuk krijojnë lidhje me të dhënat e tjera të praktikës doganore.

10. Dega e Doganës Kapshticë, të marrë masa të plota, për kompletimin e dosjeve të subjekteve që prej vitesh janë konsideruar dhe konsiderohen të besueshme, duke fituar padrejtësisht statusin e zhdoganimit me transaksion, me të gjitha dokumentet origjinale që shoqërojnë praktikën doganore, të inventarizohen dhe të arkivohen si dosje bazë.

11. Dega e Doganës Kapshticë, të marrë masa të plota që çdo përgjigje e marrë nga Laboratori Kimik Doganor i DPD-së, për klasifikimet tarifore të verifikuara, si pjesë përbërëse e praktikave doganore, përcaktuar qartë në formularin e certifikatës së cilësisë të lëshuar nga ky laborator, si dhe procesverbalet e mënyrave të asgjësimit të mostrave të marra për klasifikim tarifor, tu bashkëlidhen praktikave doganore në përputhje me kërkesat e neneve 67, 93/b, 94 të Kodit Doganor, të udhëzimit

nr.1, datë 30.01.2006 “Mbi funksionimin e procedurave laboratorike” dhe të udhëzimit nr. 11468, datë 18.10.2007, pika 10.

12. Dega e Doganës Kapshticë, të marrë masa të plota, për plotësimin e praktikave doganore me librezat e mjetit transportues dhe certifikatat e peshimit bosh, në zbatim të udhëzimit nr.1 datë 01.11.2002 ku thuhet: *“Të gjitha mjetet që kryejnë transport ndërkombëtar mallrash duhet të pajisen me certifikatën e peshimit (për mjetet bosh) sipas aneksit 1. paisja me këtë certifikatë kryhet në degët e doganave Tiranë, Durrës, Vlorë, Gjirokastër, **Kapshticë** dhe Qafë Thanë.”* Certifikatën e peshimit të mjetit duhet veç për trajlerin dhe veç për rimorkion”, si dhe në kundërshtim me, shkresën nr. 600, datë 03.12.2009, shkresën nr.27, datë 01.01.2012, si dhe shkresën nr.1467, datë 26.11.2012 ku theksohet se; *“Në të gjitha rastet ku për llogaritjen e peshës bosh të mjetit merret për bazë peshasipas librezës, një kopje e saj duhet të jetë bashkëlidhur fletës së peshimit. Është e detyrueshme administrimi i librezës së mjetit në çdo praktikë doganore bashkëlidhur kopjes origjinale të fletës së peshimit si pjesë e dokumenteve bashkëlidhur praktikës doganore”.* Në asnjë rast të mosplotësohet fleta e peshimit tek rubrika “Pesha e mjetit bosh” duke ju referuar vetëm fletës së peshimit bosh të mjetit pa e shoqëruar atë me certifikatën përkatëse të peshimit të plotësuar në të gjitha rubrikat. Një kopje e saj administrohet në çdo rast bashkëlidhur praktikës doganore.

13. Dega e Doganës Kapshticë, të marrë masa për të mbajtur në mbikëqyrje të vazhdueshme eksportin e mineraleve të ndryshme për të cilat llogaritet rentë minerare, pasi nga auditimi në disa raste ajo ka rezultuar e ulët dhe shumë e ulët, duke shkelur kërkesat e përcaktuara në shkresën nr. 16365 prot, datë 17.10.2012 të Ministrisë së Financave “Për miratimin e vlerave referuese sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin minerale nga Komisioni AD HOC mbi Rentën Minerale“. Këto veprime ndikojnë direkt jo vetëm në llogaritjen e vlerës së rentës minerare, por edhe në deklarimin e të ardhurave në eksport e për pasojë dhe në deklarimin e të ardhurave e të treguesve të tjerë financiarë në organet tatimore.

14. Dega e Doganës Kapshticë të marrë masa, që në zbatim të ligjit nr. 7726, datë 29.06.1993 “Për Arkivat” ndryshuar dhe me “Rregulloren mbi Ruajtjen e Administrimin e Dokumenteve në Administratën Shtetërore” si dhe me neni 12 të “Rregullores së Brendshme e Degëve Doganore dhe Drejtorive Rajonale” e miratuar me nr. 18029, datë 07.11.2011, të kryhet inventarizimi i praktikave doganore dhe të shoqërohen me procesverbal dorëzimi.

B-MASA PER SHPERBLIM DEMI

Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej **57,142,191 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Vlera prej **39,796,809 lekë**, nga subjektet sipas anekseve 1-1/6 dhe 2-2/3, trajtuar në faqet 17-212 të RPA, për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penaltiteve sipas KD, për pranim të vlerës së transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore, për deklaratat doganore të disa subjekteve.

2. Vlera prej **4,566,043 lekë**, nga subjektet sipas aneksit 3, trajtuar në faqet 232-253 të RPA, për auditimin e vendimeve dhe mos aplikim të gjobave në shkelje të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 Kodi Doganor i RSH, neni 256/1.2, 261/2 dhe 275 pika 1. 2.

3. Vlera prej **1,116,813 lekë**, nga subjektet sipas aneksit 4, trajtuar në faqet 256-261 të RPA, për shkelje të procedurave të vlerësimit të taksës së rentës minerare, në kundërshtim me VKM nr.7, datë 04.01.2012 “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare” ndryshuar me VKM nr. 201, datë 21.03.2012, si dhe udhëzimit nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat kombëtare”.

4. Vlera prej **10,262,526 lekë**, nga subjektet sipas aneksit 5, trajtuar në faqet nr. 265-269 të RPA, nga dy subjekte, të cilat kanë shkelur afatin e pagesës së tvsh-së për rreth 335 ditë, veprim në kundërshtim me VKM nr.599, datë 16.08.2006 “Për skemën e shtyrjes së pagesës së tvsh-së, për makineritë e pajisjet e importuara, si dhe energjinë elektrike të importuar nga KESH” me ndryshime, Udhëzimin nr.1, datë 26.09.2006 “Për zbatimin e skemës së shtyrjes së pagesës së tvsh-së që përcakton VKM nr.599, datë 16.08.2006”, dhe shkresën nr.1742, datë 08.02.2008 “Në lidhje me skemën e dhënies së autorizimit për shtyrje të pagesës së tvsh-së”.

5. Vlera prej **1,400,000 lekë**, nga subjektet sipas aneksi 6, trajtuar në faqet nr. 212-226 të RPA, gjoha të rekomanduara për mungesë të kartave teknologjike për përcaktimin e koeficientit të shfrytëzimit për artikujt e prodhuar, për diferenca të bilancit import-eksport, veprime në kundërshtim me nenin 140 të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i RSH-së”, VKM-së nr.205 datë 13.04.1999 “Për dispozitat zbatuesë të KD-së” si dhe udhëzimit nr.1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i wshtw kërkuar Drejtores së Përgjithshme të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganës Kapshticë, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme të konsideruar nga ana jonë si shkelje të rënda dhe shumë të rënda të bëjë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për dhënien e masave disiplinore sipas VKM nr. 115, datë 05.03.2014 dhe ligjit nr. 152/2013, **për 4 nëpunësit civil** të Degës së Doganës Kapshticë si më poshtë:

1. [REDAKTUAR] me detyrë Shef Turni, për shkeljet të konstatuara në 29 raste,
 2. [REDAKTUAR] me detyrë Shef turni, për shkeljet të konstatuara në 23 raste,
 3. [REDAKTUAR] me detyrë doganier Fizik/Vlerë, për shkeljet e konstatuara në 12 raste,
 4. [REDAKTUAR] me detyrë Shef turni, për shkeljet të konstatuara në 8 raste,
- Të cilët në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në pikat 6 dhe 7 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, miratuar me shkresën nr. 19095/2, datë 12.11.2011, kanë vepruar në kundërshtim me kërkesat e neneve 34-40 të KD, të VKM-së nr. 205, datë 13.03.1999 “Për dispozitat zbatuese të KD” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 “Për vlerën doganore”, me ndryshime.

Shënim:

I. Për të meta e parregullsitë e konstatuara të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, **për 19 punonjës** të cilët janë atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, kemi rekomanduar të vlerësohet shkalla e përgjegjësisë dhe të reflektohet në vlerësimin vjetor të nëpunësve.

II. Për të meta dhe parregullsitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk u rekomandua masë për **8 ish-punonjësit** e cituar në RPA, për arsye se ata i kanë shkëputur marrëdhëniet e punës me sistemin doganor.

Me ndjekien dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Auditimi u krye nga audituesit Livan Hoxha, p/grupi, Vladimir Rizvani, Brunilda Zeneli dhe Anesti Gjika, më tej u shqyrtua nga Kryeauditues z. Albert Thoma, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit znj. Albana Agolli si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Luljeta Nano.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Dega e Doganës, Kapshticë, me shkresën nr. 853/39, datë 15.07.2014 ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve nga ku rezulton se, është hartuar një Plan Organizativ masash dhe janë marrë masat përkatëse për zbatimin e të gjitha masave organizative të propozuara. Janë vlerësuar masat për shpërblim dëmi në shumën **57,142,191 lekë**, dhe janë në proces verifikimi dhe analizimi për të nxjerrë vendimet përkatëse. Masat disiplinore nuk janë zbatuar ende.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT